

NDIKIMI I LUFTËS RUSI-UKRAINË NË ARKITEKTURËN EVROPIANE TË
MBROJTJES DHE SIGURISË:
ÇKA MËSO BASHKIMI EVROPIAN?

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË INTEGRIME EVROPIANE DHE ADMINISTRATË
PUBLIKE

NGA

MIRLINDA JASHANICA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE

PRISHTINË

TETOR, 2023

NDIKIMI I LUFTËS RUSI-UKRAINË NË ARKITEKTURËN EVROPIANE TË MBROJTJES DHE SIGURISË: ÇKA MËSON BASHKIMI EVROPIAN?

Mentor. Prof. Ass. Dr. Bardhok Bashota

Qëllimi i këtij punimi ishte që të analizoj ndikimin e luftës Rusi-Ukrainë në arkitekturën e mbrojtjes dhe sigurisë të Bashkimit Evropian dhe çka mëson Bashkimi Evropian lidhur me këtë temë. Arsyeja kryesore ishte qartësimi i ndikimit të konflikteve në aspektin e mbrojtjes dhe sigurisë. Për të analizuar më mirë këtë ndikim ishte i nevojshëm bazimi në publikime të bëra nga BE, si dhe hulumtime dhe mendime të tjera nga autorë dhe agjenci të ndryshme. BE ka ritheksuar rëndësinë që ka mbrojtja dhe siguria e secilit vend anëtar të unionit apo secilit kandidat potencial. Ukraina edhe pse nuk është një vend anëtar i BE, ai është një shtet potencial për anëtarësim dhe mbi të gjitha BE kishte marrëveshje të përbashkët me të në kuadër të Partneritetit Lindor. Partneritet ky i bërë nga ana e Bashkimit dhe vendeve të Evropës Lindore, ku bën pjesë edhe Ukraina, prandaj cenimi i paqes, sigurisë dhe integritetit territorial i shtetit të Ukrainës nga ana e Rusisë ishte një akt i dënueshëm dhe i pa pranueshëm. Ky akt vëri në pikëpyetje aspektin e mbrojtjes dhe sigurisë së përbashkët e cila proklamohet nga ana e Bashkimit Evropian duke detyruar këtë të fundit të rishikoj këto politika, duke u munduar ti përshtat me situatën e re të krijuar.

PËRMBLEDHJE

Secili shtet ka të drejtë të jetë i mbrojtur dhe të ketë mundësi të jetoj pa frikë se mund t'i rrezikohet siguria, prandaj rrezikimi i sigurisë nga një shtet tjetër është një problem me të cilin nuk ballafaqohet vetëm një shtet i caktuar. Secili tensionim i raporteve mes shteteve e shton kërkesën për mbrojtje dhe duke e marrë parasysh se shtetet e kanë të vështirë të mbrohen vetëm, shtohet kërkesa për mbrojtjen nga një fuqi më e madhe siç është Bashkimi Evropian (BE). Ndikimet e jashtme të cilat vijnë në drejtim të mbrojtjes dhe sigurisë janë të shumta, e ndër më të frikshmet është ndikimi që vjen si pasojë e një lufte në një shtet të caktuar. Luftërat ndikojnë tek shtetet duke e shtuar frikën për sigurinë, si dhe vënë në pikëpyetje rezultatet e arritura në

aspektin e mbrojtjes së përbashkët të BE-së. Duke u bazuar në rëndësinë dhe ndikimin që kjo temë aktuale ka në arkitekturën e mbrojtjes dhe sigurisë të BE-së, elaborimi i saj është i një rëndësie tejet të veçantë. Ekzistojnë dy lloje të politikave me të cilat BE operon kur bëhet fjalë për mbrojtje të shteteve nga cilido rrezik eventual si dhe për ruajtjen e paqes dhe sigurisë të përbashkët. Këto dy politika janë: 1. Politika e Përbashkët e Mbrojtjes dhe e Sigurisë dhe 2. Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë. Pika kryesore e këtyre politikave është mbrojtja e sigurisë të secilit shtet nga dukuritë të cilat konsiderohen të rrezikshme dhe të pa pranueshme nga BE. Mbrojtja nga konfliktet ose konfliktet e armatosura, konkretisht nga lufta përbënë rëndësinë më të madhe. BE duhet të jetë në gjendje të kujdeset për interesat e veta të sigurisë dhe të mbajë pjesën e tij të përgjegjësisë si një ofrues global i sigurisë.

Kur bëhet fjalë për ndikimin që ka pasë lufta e Rosisë në Ukrainë në arkitekturën e mbrojtjes dhe sigurisë vlenë të theksohen edhe tre fakte të rëndësishme: *Së pari* shpenzimet e mbrojtjes janë rritur duke vendosur një rritje të buxheteve evropiane të mbrojtjes në vitet e ardhshme. Edhe pse ka dallime në shpenzimet e mbrojtjes midis shteteve që janë afër luftës dhe atyre që nuk janë. *Së dyti* shtetet evropiane po investojnë në sistemet dhe platformat e disponueshme të armëve. Ndhima e tyre ushtarake për Ukrainën po krijon një emergjencë të mbrojtjes kombëtare në çdo vend, të cilën ata po adresojnë duke blerë çfarëdo që është në dispozicion. *Së treti* sëmundja kryesore e mbrojtjes evropiane është fragmentimi që rrezikon të përkeqësohet. Fragmentimi i mbrojtjes është një problem i madh në Evropë. Të shpenzosh më shumë për mbrojtjen nuk do të thotë domosdoshmërisht të shpenzosh më mirë. Në mënyrë që evropianët të bëhen më të aftë përse i përket mbrojtjes, ata duhet të shpenzojnë më shumë dhe të shpenzojnë së bashku.

Si përfundim, Bashkimi Evropian duhet të punojnë më shumë në forcimin e politikave të mbrojtjes dhe sigurisë, në hartimin e politikave të reja, po ashtu duhet të punoj më shumë në unitetin mes vendeve anëtare në mënyrë që të ketë ndikim ende më të madh në mbrojtjen e sigurisë dhe paqes së vendeve anëtare, por edhe më gjerë. Mbështetja e Bashkimit Evropian për mbrojtjen dhe sigurinë duhet të jetë pikësynim i saj, duke i marrë parasysh rreziqet që po i kanosen vazhdimisht sigurisë evropiane dhe globale. Bashkimi Evropian duhet të jetë strehë mbrojtjeje dhe sigurie për secilin vend anëtar dhe vend potencial për anëtarësim.

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E KAPITUJVE

Punimi ndahet në pesë kapituj të cilët përbëjnë secili rëndësinë e tyre në elaborimin e temes si në vijim:

Kapitulli i parë përbën një pasqyrë të Politikës Evropiane të Mbrojtjes dhe Sigurisë, e bashkë me të rëndësi të veçantë do të ketë edhe Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë, duke e marrë parasysh ndërlidhjen mes tyre. Nënkapitulli i parë përbëhet nga natyra dhe objektivat e kësaj politike. Nënkapitulli i dytë ka për qëllim qartësimin e bazës juridike dhe institucionale. Nënkapitulli i tretë ka fokus tek raporti BE-vendet anëtare në kuadrin e politikës së mbrojtjes dhe sigurisë. Në nënkapitullin e katërt do qartësoj më shumë bashkëpunimin e BE-së me NATO-në duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre dy organizatave në lëmin e mbrojtjes dhe sigurisë. Kurse në nënkapitullin e pestë do të jetë fokusi në politikat strategjike të Bashkimit Evropian.

Kapitulli i dytë do të përmbajë analizimin e Politikës Evropiane të Fqinjësisë dhe Partneritetin Lindor. Dimensionet, format dhe sfidat e BE-së do analizohen në nënkapitujt e tjerë. Bashkëpunimi i BE-së me shtetet e Evropës Lindore, ka një nënkapitull të veçantë. Si dhe nënkapitulli i fundit përmban bashkëpunimin e BE-së me Ukrainën në kuadër të këtij partneriteti.

Kapitulli i tretë përmban dinamikën e luftës, historikun e konfliktit dhe kalimin e tij në luftë si dhe shkaqet kryesore të konfliktit. Përkitazi me të edhe rolin e Bashkimit Evropian në vendosjen e paqes, veprimet dhe masat e ndërmarra ndaj Ruisë dhe mbështjetjen e Bashkimit Evropian për shtetin ukrainas.

Kapitulli i katërt do ketë në fokus ndikimin i luftës në politikën e mbrojtjes dhe sigurisë. Nën kapitujt e tjerë kanë për bazë ndikimin e saj në politikën e jashtme dhe të sigurisë, si dhe në aspektin e mbrojtjes dhe sigurisë. Rëndësi të veçantë kanë edhe dy nënkapitujt mbi rolin e vendeve anëtare në këtë politikë, si dhe rolin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si partner në forcimin e kësaj politike.

Kapitulli i pestë është elaborim i të ardhmës së luftës dhe si pritet të veproj Bashkimi Evropian në lidhje me vazhdimin e kësaj lufte dhe se si ndikoi lufta në krizën ekonomike e cila kaploi të gjitha vendet duke përfshirë edhe vendet të cilat nuk janë pjesë e Bashkimit Evropian. Marrë parasysh se Rusia dhe Ukraina janë dy eksportuesit më të mëdhenj të grurit dhe shumë kulturave tjera të rëndësishme.

METODOLOGJIA

Për realizmin e punimit “Ndikimi i luftës Rusi-Ukrainë në arkitekturën evropiane të mbrojtjes dhe sigurisë: Çka mëso Bashkimi Evropian?” është përdorë metoda cilësore. Punimi ka marrë formën e tij duke analizuar libra, artikuj, analiza dhe hulumtime të bëra nga autorë vendorë dhe ndërkombëtarë, lidhur me ndikimin e konfliktit Rusi-Ukrainë në politikën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe rolin i Bashkimit Evropian drejtë këtij konflikti. Literatura në të cilën është i bazuar punimi është e përgjithëshme, mirëpo theks të veçantë kanë raportet dhe publikimet nga ana e Bashkimit Evropian. Përfundimet, rezultatet e arritura, rekomandimet, rëndësia e pyetjes hulumtuese, validiteti ose jo validiteti i hipotezave janë paraqitur në fund të punimit.

Studimi synon të jap përgjigje në pyetjet hulumtuese:

- Si ndikoi lufta Rusi-Ukrainë në arkitekturën evropiane të mbrojtjes dhe sigurisë?
- Cilat ishin veprimet që mori BE për përmirësimin e Politikës Evropiane të Mbrojtjes dhe Sigurisë pas pushtimit rus në Ukrainë?